



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KRYETARI



Nr. 4149 prot.

Gramsh, më 25/09/2024

RELACION
PËR

Përfaqësuesit, në Bordet e Shkollave dhe Kopshteve nga Njësia e Vetqeverisjes Vendore.

Të nderuar këshilltarë !

Në përmbushje të detyrave tona funksionale, mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9 gërma -a- dhe neni 54 pika k; Udhëzimit nr.25 datë 25/07/2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e Bordit të Institucionit Arsimit” si dhe Udhëzimit të Përbashkët nr.13, datë 10 / 07 / 2024 “Për Vitin Shkollor 2024-2025 në Sistemin Arsimit Parauniversitar” të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me Ministrinë e Financave, paraqesim këtë relacion për miratimin e përfaqësuesve të Qeverisjes Vendore në Bordet e Institucioneve të Arsimit Parauniversitar që ndodhen në territorin e Bashkisë sonë. Bordi në këto Institucione, ka për mision të sigurojë që shërbimi arsimor të kryhet sipas politikave arsimore kombëtare e lokale dhe interesave të komunitetit nëpërmjet njohjes së problemeve, zgjidhjes dhe adresimit të tyre. Bordi kontribuon për mbarëvajtjen e Institucionit Arsimit në përputhje me Aktet Ligjore në fuqi duke miratuar veprimtarinë e Institucionit si:

- Planin Afatmesëm dhe Planin Vjetor.
- Miraton kurrikulën e hartuar nga Institucioni Arsimit.
- Miraton planin e shpenzimeve të Institucionit Arsimit për fondet të cilat sigurohen nga Institucioni.
- Shqyrton rregulloren e brendshme të funksionimit të Institucionit.
- Shqyrton raportin vjetor financiar.
- Ndjek përmbushjen e objektivave të Planit Vjetor të Institucionit.
- Paraqet shqetësimet e qytetarëve dhe prindërve tek drejtuesit e Institucionit, për të përmbushur nevojat e nxënësve / fëmijëve etj.....

Sa më lart, ju ftojme të nderuar këshilltarë, të njiheni e diskutoni duke miratuar përfaqësuesit e Qeverisjes Vendore sipas Projekt-Vendimit, bashkëlidhur këtij relacioni.

Drejtori i Arsimit, Kulturës dhe sportit

Kalem HASA

KRYETARI
Besion AJAZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4199/prot.

Gramsh, më 25 / 09 / 2024

PROJEKT – VENDIM

Nr. _____, datë ____ / ____ 2024

Për përfaqësuesit, në Bordet e shkollave dhe kopshteve nga Njësia e Vetqeverisjes Vendore.

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” neni 8 pika 2, neni 9 germa a dhe neni 54 pika k; të Udhëzimit nr. 25 datë 25/07/2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e Bordit të Institucionit Arsimit” dhe Udhëzimit të Perbashket nr.13, datë 10 / 07 / 2024 “Për Vitin Shkollor 2024-2025 në Sistemin Arsimit Parauniversitar” të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me Ministrinë e Financave

P R O P O Z O J:

1-Të miratohen përfaqësuesit e Bashkisë Gramsh për në Bordet e Institucioneve Arsimore të Shkollave dhe Kopshteve për Vitin Shkollor 2024 – 2025, me përbërjen si më poshtë:

Nr	Institucioni	Nj. Administrative	Emër, mbiemër
1	Shkolla e Mesme “Shefqet Guzi”	Qytet	Marije Kola
2	Shkolla 9-Vjeçare “Rilindja”	Qytet	Loina Zogu
3	Shkolla 9-Vjeçare “35-Vjetori”	Qytet	Ardit Janca
4	Shkolla 9-Vjeçare “Asllan Shahini”	Qytet	Jolanda Llapushi
5	Shkolla e Mesme e Bashkuar Poroçan	Poroçan	Gani Paja
6	Shkolla e 9-Vjeçare Kushovë	Kushovë	Durim Zani
7	Shkolla e Mes. e Bashkuar Skënderbegas	Skënderbegas	Mirgen Çela
8	Shkolla e Mesme e Bashkuar Kukur	Kukur	Manjola Sollaku
9	Shkolla 9-Vjeçare Çekin	Pishaj	Endri Mema
10	Shkolla e Mesme e Bashkuar Tunjë	Tunjë	Ramiz Zenuni
11	Shkolla e Mesme e Bashkuar Kodovjat	Kodovjat	Aldo Tafa
12	Shkolla e Mesme e Bashkuar Gjergjovinë	Pishaj	Hyqmet Zogu
13	Skolla 9-Vjeçare Gribë	Kukur	Luan Kokla
14	Kopshti nr.1	Qytet	Anita Duzha
15	Kopshti nr.2	Qytet	Kristina Llapushi
16	Kopshti nr.3	Qytet	Maringlena Braho

2-Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen anëtarët e Bordit, Drejtoritë e Shkollave dhe të Kopshteve, Drejtoria e A.K.S. Vendimi hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini

Kryetari Këshillit
Eno Zani